

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**VERTEX INVEST SH.P.K.**

**KAPITULLI I**  
**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**NENI 1**  
**EMRI**

Sot më datë 15.03.2021 Ortakët themelues **Z. Luis Hoxha** dhe **Z. Arian Cara**, themelojnë shoqërinë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “**VERTEX INVEST**” Sh.p.k., në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar në Republikën e Shqipërisë.

**Z. Luis Hoxha** me atësi Avni, i datëlindjes 10.06.1988, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me Numër Personal Identifikimi I80610092C.

**Z. Arian Cara** me atësi Shyqyri, i datëlindjes 18.06.1983, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me Numër Personal Identifikimi I30618202I.

Ortakët themelues **Z. Luis Hoxha** dhe **Z. Arian Cara**, formulojnë Statutin e Shoqërisë si më poshtë.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë është në **Rr. Ibrahim Rrugova, Kompleksi Green Park, Shkalla 1, Kati VI-të, Ap. 34, Tiranë Shqipëri.**

Shoqëria do të ketë edhe vend qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me aprovimin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është i pa përcaktuar.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

1. Investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme). Investime në instrumenta financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj);
2. Kryerjen e operacioneve me pasuri të paluajtshme: blerje, shitje, qiradhënie dhe çdo natyrë tjetër shërbimi lidhur me këto pasuri. Veprimtari ekonomike në fushën e real estate (pasurive të paluajtshme), që ka të bëjë me negociime, ndërmjetësime, përfaqësime të të tretëve si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ndërmjetësim për blerje, shitje dhe dhënie me qira të pasurive të paluajtshme;
3. Në fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, projektme, prodhim materiale ndërtimi, mbikqyrje, kolaudim, etj. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore. Rikonstruksione;
4. Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt apo indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar; Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa, në resorte apo struktura turistike dhe në komplekse rezidenciale.
5. Tregtimi me shumicë e pakicë, import-eksport i mallrave dhe materiale të ndryshme industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, makineri e pajisje të ndryshme, pajisje ndërtimi, pajisje elektrike edhe elektronike, pajisje hidraulike, hidrosanitare, elektrike, materiale ndërtimi, mallra të të gjitha llojeve.
6. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës të cilët përfshijnë konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, etj.) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.
7. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqërisë.

#### NENI 5 E DREJTA

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi si Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar) e në përputhje dhe në zbatim të Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartpërmendura.

#### NENI 6

NENI 6  
PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Gjatë ushtrimit të të drejtave ortakët e shoqërisë veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorin e shoqërisë.

KREU II  
KAPITALI SHOQËRISË, MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE  
ADRESA E ORTAKËVE, VULA E SHOQËRISË

NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 3.000.000 (tremilion) lekë dhe përfaqësohet nga kontribute në para të ortakëve themelues të cilat do të depozitohen në llogarinë bankare të shoqërisë pas regjistrimit të saj.

Pjesëmarrja e ortakëve është si më poshtë:

- **Z. Luis Hoxha**, zotëron 50% (pesëdhjet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 1 (një) kuotë, në vlerë të barabartë me 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
- **Z. Arian Cara**, zotëron 50% (pesëdhjet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 1 (një) kuotë, në vlerë të barabartë me 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

Kapitali i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8  
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 9

NENI 9  
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit mund të shiten nga ortakët e shoqërisë me vlerën nominale ose sipas një vlere tjetër të pranuar midis shitësit dhe blerësit. Shitja e kuotave duhet të jetë në përputhje me kuotat e poseduara nga ortakët dhe ju bëhet e njohur me akt të shkruar dhe regjistruar në rregjistrin e shoqërisë.

Kuotat e kapitalit themeltar mund tu transferohen lirisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nëse ky vendim është i aprovuar nga ortakët që përfaqësojnë totalisht të paktën 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kuotat e kapitalit, në rast vdekje i kalojnë trashëgimtarëve duke hyrë këta të fundit në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut.

NENI 10  
ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

Mund të procedohet me anulimin e kuotave mbi të gjitha kur sjellja e ortakut është pengesë në kryerjen e aktivitetit dhe detyrave statutore të shoqërisë. Në këtë rast, ortakut likujdohet, dhe vlera e kuotës së tij dhe kuotat e tij u ndahen ortakëve të tjerë që bëjnë kërkesë, gjithmonë në mënyrë proporcionale me kuotat e kapitalit që tashmë disponojnë.

NENI 11  
SHPËRNADARJA E FITIMIT

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim sipas parashikimeve në nenet 77,78, 79 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

NENI 12  
PËRGJEGJËSIA E SHOQËRISË

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiake për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimtaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 13

## ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve përsa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo e regjistruar në librin e ortakëve themelues të shoqërisë e cila mund të përditësohet. Do të jetë detyrim i ortakëve të komunikojnë me shkrim me anë të rekomandës me lajmërim marrje që vërteton dorëzimin efektiv në një vendbanim të ndryshëm nga ai i deklaruar më parë. E njëjta procedurë do të zbatohet për çdo përditësim të mëtejshëm.

### NENI 14 VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me të njëjtin emërtim si vetë shoqëria. Përdorimi i vulës është i rezervuar ekskluzivisht administratorit, me përjashtim të një ortaku tjetër që të jetë posaçërisht i deleguar.

### KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

#### NENI 15 ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoro, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;



Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori/ët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### NENI 16

#### MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në këtë mënyrë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë Administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat Asambleja duhet të marrë vendim.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve drejtohet nga Administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njëri prej ortakëve i zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën 2 herë në vit.

#### NENI 17

#### KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të thjeshtë Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast, vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipar Nenit 87 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve;
- e. mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë.

#### NENI 18 E DREJTA E VOTËS

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote duke kuptuar me shprehjen “çdo kuotë” posedimin e të paktën të një vlere 1% të kapitalit të shoqërisë. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

#### NENI 19 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### NENI 20 PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës,

emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## NENI 21

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i shoqërisë realizohet nga Administratori i saj Z. Luis Hoxha, i datëlindjes 10.06.1988, lindur në Durrës, me zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me Numër Personal Identifikimi I80610092C, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë riemërimit nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë.

Konkretisht, administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## NENI 22

### DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

Administratori, përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, detyrohet: a) të kryejë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b)



të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; e) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) shpërndan aktivet e shoqërisë; d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; d) jep kredi.

#### KREU IV VITI FINACIAR, EKSPERTI KONTABËL

##### NENI 23 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### NENI 24 EKSPERTI KONTABËL

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij në rastet kur ai është ngarkuar dhe e ka kryer, i ngarkuar nga Ortakët.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara për të cilat është I detyruar t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar në bazë të kompetencave të Asamblesë së Përgjithshme.

## KREU V LARGIMI I ORTAKËVE

### NENI 25 LARGIMI I ORTAKËVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria.

### NENI 26 PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku: a) me dashje apo me pakujdesi të rënde shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës për përjashtimin. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

## KREU VI PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

### NENI 27 PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të asamblesë së përgjithshme; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës; dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

### NENI 28 LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU VII  
ZBATIMLI LIGJIT

NENI 29  
ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut vlejné dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 30

Ky akt u redaktua në gjashtë kopje për t’ju shpërndarë ortakëve dhe organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

**LUIS HOXHA**



**ARIAN CARA**

